



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori k. Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 18 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

PËRMBAJTJA

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIMET E PALËVE	3
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
	MOCIONET PARAPRAKE.....	5
	BURIMET LIGJORE DHE NORMAT E INTERPRETIMIT	5
	AKTAKUZA.....	6
IV.	DISKUTIM	6
	A. Aspekte paraprake.....	6
	STANDARDET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME FORMËN E AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR.....	10
	B. AKUZAT E SHUMËFISHTA	15
	ARGUMENTIMI I FORMAVE TË PËRGJEGJËSISË PENALE.....	19
	ARGUMENTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS	36
	PËRFUNDIM.....	43
V.	VENDIM.....	44

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 97(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (“Vendimi i Konfirmimit”),² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala” ose “i akuzuari”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).⁵
3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redakte dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

4. Më 13 korrik 2021, në vijim të një urdhri gojor për ndryshimin e afateve përkatëse për paraqitjen e parashtrimeve,⁷ Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") dorëzoi një mocion paraprak për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar ("Mocioni i Mbrojtjes").⁸

5. Më 6 shtator 2021, në vijim të një vendimi për ndryshimin e mëtejshëm të afateve përkatëse për paraqitjen e parashtrimeve ("Vendimi i 5 korrikut 2021") dhe një vendimi për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve,⁹ ZPS-ja dorëzoi përgjigjen e saj ("Përgjigjja").¹⁰

6. Më 24 shtator 2021, në vijim të vendimit të 5 korrikut 2021 dhe të një urdhri gojor për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve,¹¹ Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen ("Kundërpërgjigjja").¹²

II. PARASHTRIMET E PALËVE

7. Mbrojtja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar është e mangët për shkak të:
(i) akuzave të shumëfishta të ZPS-së për krimet dhe format e përgjegjesisë penale;
(ii) argumentimit të mangët të krimeve të luftës; (iii) argumentimit të mangët të

⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021, f. 62, rreshtat 12-19, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00055, Mbrojtja e z. Shala, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 13 korrik 2021, konfidencial (versioni i korrigjuar u dorëzua më 15 korrik 2021, F00055/COR dhe versioni i redaktuar publik më 9 shtator 2021, F00055/COR/RED). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mocioni i Mbrojtjes u dorëzua pas kalimit të afatit përkatës, përkatësisht 12 korrikut 2021. Mbrojtja nuk dha ndonjë shpjegim në lidhje me vonesën dhe nuk kërkoi zgjatje të afatit, sipas rregullës 9(5) të Rregullores. Sidoqoftë, pavarësisht nga këto mangësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen aktuale e pranon këtë mocion, në interes të drejtësisë dhe të ruajtjes së interesave të të akuzuarit. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i tërheq vëmendjen Mbrojtjes që në të ardhmen të respektojë afatet dhe të kërkojë ndryshimin e tyre në kohën e duhur, nëse nuk do të jetë në gjendje të dorëzojë parashtrimet e saj brenda afateve të përcaktuara.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Ndryshim të Afatit*, 5 korrik 2021, publik; F00067, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Tejkallim të Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 3 shtator 2021, publik, para. 10, 14(a).

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00070, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Versionit të Korrigjuar të Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së Shalës për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 6 shtator 2021, konfidenciale.

¹¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 23 shtator 2021, f. 101, rreshti 19 – f. 102, rreshti 7, publik.

¹² KSC-BC-2020-04, F00083, Mbrojtja e z. Shala, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin Paraprak të Pjetër Shalës për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 24 shtator 2021, konfidenciale.

formave të përgjegjesisë penale; (iv) përdorimit të formulimeve të mjegullta dhe të paplota; dhe (v) mosdhënies së informacionit të mjaftueshëm në lidhje me faktet materiale dhe elementet e krimeve që parashtrihen.¹³ Mbrojtja gjithashtu pretendon se procedura e konfirmimit të aktakuzës ishte në kundërshtim me të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë, siç përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-123 ("KPPK").¹⁴ Rrjedhimisht, duke pasur parasysh mangësitë e identifikuar, Mbrojtja kërkon që ZPS-ja të urdhërohet të ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar, ose të heqë prej saj akuzat dhe format e përgjegjesisë që kanë mangësi.¹⁵

8. ZPS-ja përgjigjet se mocioni i Mbrojtjes nuk identifikon ndonjë mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores dhe, rrjedhimisht, duhet të hidhet poshtë. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se, në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, Aktakuza e Konfirmuar paraqet një përshkrim të shkurtër të fakteve materiale të çështjes së ZPS-së dhe të veprave penale e formave të përgjegjesisë në lidhje me të cilat janë ngritur akuzat.¹⁶ Së fundi, ZPS-ja konsideron se kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj procedurës së konfirmimit janë parashtruar në mënyrë të gabuar dhe janë gjithsesi të pabaza.¹⁷

9. Mbrojtja kundërpërgjigjet në lidhje me çështjet që dalin nga përgjigjja e ZPS-së.¹⁸ Ajo gjithashtu i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të thërrasë një seancë gjatë së cilës Mbrojtja të mund të shtjellojë gojarisht parashtrimet e paraqitura në mocionin dhe kundërpërgjigjen e saj.¹⁹

¹³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 14-64.

¹⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 11-13.

¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3, 66.

¹⁶ Përgjigjja, para. 1.

¹⁷ Përgjigjja, para. 12-13.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 2, 4-17.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 19(iii).

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

MOCIONET PARAPRAKE

10. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për të vendosur në lidhje me çdo mocion paraparak, përfshirë edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës.

11. Sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores, i akuzuari mund t'i paraqesë mocione paraprake Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, të cilat pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës.

BURIMET LIGJORE DHE NORMAT E INTERPRETIMIT

12. Neni 3(2) i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara ("DHS") gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me:

- a. Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetuta");
- b. këtë ligj, si *lex specialis*;
- c. dispozitat e tjera të ligjeve të Kosovës, të përfshira shprehimisht në këtë ligj;
- d. të drejtën zakonore ndërkombëtare, së cilës i jepet përparësi kundrejt ligjeve vendase me nenin 19(2) të Kushtetutës, dhe
- e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilës i jepet përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 22 të Kushtetutës.

13. Neni 3(4) i Ligjit parashikon më tej se çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk është përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohet për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e DHS-së dhe ZPS-së dhe se ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji apo rregulloreje tjetër.

AKTAKUZA

14. Sipas nenit 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij.

15. Sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim të shkurtër të fakteve të çështjes dhe të veprës ose veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari dhe në veçanti formën e përgjegjësisë penale të pretenduar në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, pra provat në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat, si dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE PARAPRAKE

1. Kërkesa për seancë publike

16. Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të thërrasë një seancë në mënyrë që Mbrojtja të shtjellojë gojarisht parashtrimet e paraqitura në mocionin dhe kundërpërgjigjen e saj.²⁰

17. Rikujtojmë se, sipas kornizës ligjore të DHS-së, seancat gojore janë rreptësisht të domosdoshme në raste të caktuara,²¹ ndërsa në raste të tjera ato mund të mbahen në varësi të gjykimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.²² Sa u përket çështjeve që

²⁰ Kundërpërgjigja, para. 19(iii).

²¹ Për shembull, Neni 41(5) i Ligjit; Rregulla 92 e Rregullores (paraqitjet e para); Rregulla 96 e Rregullores (konferencat mbi ecurinë e çështjes gjyqësore).

²² Për shembull, Rregulla 95(2)(d) e Rregullores; KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik, para. 62; F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kryerjen e Rishikimit të Paraburgimit dhe Ndryshimin e Afatit për Mocionet Paraprake*, 16 dhjetor 2020, publik, para. 18.

dalin nga Mocioni i Mbrojtjes, sipas Ligjit dhe Rregullores mbajtja e një seance gojore nuk është e detyrueshme.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja nuk ka parashtruar arsye konkrete që tregojnë pse kërkohet mbajtja e një seance gojore. Gjithashtu, siç u përmend më lart, Mbrojtjes i është miratuar një zgjatje e afatit për të paraqitur mocionin e saj dhe tejkalimi i numrit të lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e saj.²³ Rrjedhimisht, Mbrojtjes i është dhënë një mundësi e mjaftueshme për të paraqitur parashtrimet e saj. Gjithashtu, duke marrë parasysh parashtrimet e shumta të palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se ai ka informacion të mjaftueshëm për të vendosur në lidhje me mocionin e Mbrojtjes dhe se argumentimet gojore shtesë nuk janë as të nevojshme dhe as ndihmojnë në shqyrtimin e shpejtë të çështjeve në fjalë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzon kërkesën e Mbrojtjes.

2. Drejtësia e procedurës së konfirmimit të aktakuzës

19. Mbrojtja parashtron se procedura e konfirmimit të aktakuzës është zhvilluar *ex parte* për më shumë se një vit, në kundërshtim me të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.²⁴ Më konkretisht, Mbrojtja pretendon se, ndonëse aktakuza iu dorëzua për konfirmim Gjykatësit të Procedurës Paraprake më 14 shkurt 2020, z. Shala u informua për të vetëm më 16 mars 2021, ku u arrestua.²⁵ Sipas mendimit të Mbrojtjes, një qasje e tillë është në kundërshtim të plotë me procedurat e përcaktuara në nenet 242 dhe 245 të KPPK-së, të cilat parashikojnë që të pandehurit duhet t'i jepet aktakuza më së voni në shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës dhe me nenin 244 të KPPK-së, i cili parashikon që Mbrojtja duhet të njoftohet për provat kryesore që mbështesin akuzat e Prokurorisë jo më vonë se nga

²³ *Shih* para. 4 dhe 6 më lart.

²⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 11.

²⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 12 dhe poshtëshënimi 11.

ngritja e aktakuzës.²⁶ Për këto arsye, Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të jetë rigoroz në vlerësimin e Mocionit të Mbrojtjes.²⁷

20. ZPS-ja përgjigjet se, meqenëse kundërshtimi i Mbrojtjes nuk është përfshirë në mangësitë e pretenduara të Aktakuzës së Konfirmuar dhe meqë nuk është kërkuar ndonjë masë ndreqëse konkrete, ai nuk duhet të konsiderohet si pjesë e Mocionit të Mbrojtjes.²⁸ Sidoqoftë, ZPS-ja pretendon se kundërshtimet ndaj procedurës së konfirmimit të aktakuzës nuk janë kundërshtime ndaj formës së aktakuzës.²⁹ Gjithashtu, meqenëse Ligji funksionon si *lex specialis* dhe meqë vetëm legjislacioni i Kosovës që përfshihet shprehimisht në këtë Ligj zbatohet brenda kornizës ligjore të DHS-së, dispozitat e KPPK-së që nuk janë të përfshira në këtë Ligj, nuk zbatohen për proceset në DHS.³⁰

21. Mbrojtja kundërpërgjigjet se, për shkak të procedurës tejet paragjyquese të konfirmimit që cenon të drejtat e z. Shala sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“KEDNJ”), ajo ftonte Gjykatësin e Procedurës Paraprake të korrigjonte këtë paragjykim duke rishqyrtuar konstatimet e tij të mëparshme.³¹

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se çdo mocion paraprak që kundërshton aktakuzën mund të bëhet vetëm në lidhje me formën e saj. Pavarësisht nga kjo, neni 39(1) i Ligjit përcakton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të marrë vendim lidhur me çdo mocion paraprak, përfshirë, ndër të tjera, edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës dhe juridiksionit.³² Rrjedhimisht, Gjykatësi i

²⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 12.

²⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 13.

²⁸ Përgjigjja, para. 12.

²⁹ Përgjigjja, para. 13.

³⁰ Përgjigjja, para. 13.

³¹ Kundërpërgjigjja, para. 4.

³² Për ngjashmëri, KSC-BC-2020-04, F00088, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara* (“Vendimi në lidhje me Juridiksionin”), 18 tetor 2021, publik, para. 69.

Procedurës Paraprake do të trajtojë kundërshtimin e Mbrojtjes në lidhje me drejtësinë e procedurës së konfirmimit të aktakuzës sipas nenit 39(1) të Ligjit.

23. Në këtë aspekt, duke qenë se Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të jetë rigoroz në vlerësimin e Mocionit të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se vlerësimi i Mocionit të Mbrojtjes është i pavarur nga lloji i procedurës në lidhje me konfirmimin e aktakuzës. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë Aktakuzën e Konfirmuar duke pasur parasysh kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja në përputhje me standardet e zbatueshme dhe rezultati i këtij vlerësimi nuk është në asnjë mënyrë i paracaktuar, i kufizuar apo ndryshe i ndikuar nga procedura e konfirmimit. Gjithashtu, përderisa pretendimi i Mbrojtjes se procedura e konfirmimit të aktakuzës ishte e padrejtë, mbështetet në nenet 242, 244 dhe 245 të KPPK-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se këto nene nuk janë përfshirë shprehimisht në Ligj. Rrjedhimisht, duke rikujtuar se çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk është përfshirë shprehimisht në këtë Ligj, nuk zbatohet për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e DHS-së dhe ZPS-së dhe se ky Ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji apo rregulloreje tjetër, mbështetja e pretendimit të Mbrojtjes në to për parregullsi në procedurën e konfirmimit, është e gabuar.³³

24. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me drejtësinë e procedurës së konfirmimit.

³³ *Shih, për ngjashmëri*, KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës ("Vendimi në lidhje me Aktakuzën Thaçi dhe të tjerët)*, 22 korrik 2021, konfidencial, para. 49. Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00413/RED; F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmerisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve*, 31 gusht 2021, publik, para. 73-74; KSC-BC-2018-01, IA001-F00005, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin ndaj "Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Laçit"*, 1 tetor 2021, publik, para.16.

STANDARDET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME FORMËN E AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR

1. Konkretësia dhe qartësia

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me nenet 21(4)(a) dhe 38(4) të Ligjit, si edhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë faktet në të cilat mbështeten akuzat dhe veprat penale, përfshirë format e përgjegjesisë të përfshira në aktakuzë, të paraqitura me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme.³⁴ Kjo konkretësi dhe qartësi duhet të sigurojë që Aktakuza, si dokument më vete,³⁵ t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.³⁶ Rrjedhimisht, i akuzuari nuk duhet të ketë nevojë të konsultojë dokumente të tjera për të kuptuar dhe ndërtuar tablonë tërësore të pretendimeve faktike mbi të cilat mbështeten akuzat.³⁷

26. Konstatimi nëse një fakt mbështet një akuzë të caktuar dhe, rrjedhimisht, duhet paraqitur në aktakuzë me konkretësi, nuk mund të bëhet në përgjithësi, por rast pas rasti, duke marrë parasysh ndër të tjera llojin dhe peshën e veprave penale të parashtruara në aktakuzë, rrethanat e çështjes, afërsinë e pretenduar të të akuzuarit

³⁴ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 27; KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake ("Vendimi mbi Apelet Gucati dhe Haradinaj")*, 23 qershor 2021, publik, para. 35; F00147, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me Mocionet Paraprake ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake Gucati dhe Haradinaj")*, 8 mars 2021, konfidencial, para. 38 (versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00147/RED).

³⁵ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 27; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38; KSC-BC-2020-04, F00003, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020 ("*Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4)*"), publik, para. 11.

³⁶ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 27, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 36; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38. *Shih gjithashtu*, Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 9, 11.

³⁷ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 27, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 49; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 11.

me ngjarjet dhe formën e përgjegjesisë penale të parashtruar në aktakuzë.³⁸ Megjithatë, në disa raste, nuk mund të përjashtohet mundësia që disa hollësi të caktuara të çështjes, si numri dhe identiteti i viktimave,³⁹ të mbeten të fshehta edhe pas përfundimit të gjykimit.⁴⁰ Gjithsesi, kur shqyrtohet nëse aktakuza i përmbush kushtet e lartpërmendura, aktakuza duhet parë në tërësi dhe paragrafë apo fraza të veçuara duhen lexuar në kuadër të të gjithë dokumentit.⁴¹

27. Gjithashtu, duhet bërë qartë dallimi midis fakteve ku mbështeten akuzat, të cilat duhen paraqitur siç thuhet më lart, dhe provave të propozuara për t'i vërtetuar këto.⁴² Nuk është nevoja që aktakuza të paraqesë provat me të cilat vërtetohen faktet ku mbështeten akuzat.⁴³ Këto prova do të nxirren në bazë të dispozitave përkatëse. Çdo mosmarrëveshje lidhur me pikat faktike do të zgjidhet në fazën e gjykimit dhe jo përmes mocioneve paraprake mbi formën e aktakuzës.⁴⁴ Gjithsesi, kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara siguron se, krahas procesit të nxjerrjes së informacionit, të akuzuarit i vihen në dispozicion në një fazë të hershme edhe hollësi të tjera provuese në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b), në Vendimin e Konfirmimit dhe në parashtrimet e bëra në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores.⁴⁵

³⁸ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 28, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38, 42; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 39; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 15.

³⁹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 28, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 39.

⁴⁰ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 28, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*.

⁴¹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 28, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 56; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 39.

⁴² Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 29, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në "*Gucati dhe Haradinaj*", para.40.

⁴³ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 29, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 40.

⁴⁴ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 29, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 40.

⁴⁵ *Shih* Rregullat 86(3), (5) dhe 95(4) të Rregullores; Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 29, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 40.

28. Së fundi, kundërshtimet lidhur me elementet juridike të një vepre penale apo të një forme përgjegjësie penale nuk përbëjnë kundërshtime ndaj formës së aktakuzës, por janë aspekte që trajtohen në fazën e gjykimit.⁴⁶

2. Hollësitë

29. Kur pretendohet se i akuzuari i ka kryer personalisht veprimet ku mbështeten veprat penale të përfshira në aktakuzë, është e nevojshme të jepen, aq sa është e mundur dhe me “saktësinë më të madhe”⁴⁷: identiteti i viktimës (viktimave); vendngjarja dhe data e përafërt e veprimeve të pretenduara; mënyra dhe mjetet me anë të të cilave janë kryer dhe elementi mendor i lidhur me to.⁴⁸

30. Nga ana tjetër, kur nuk pretendohet se i akuzuari e ka kryer drejtpërdrejt krimin ose kur krimet synojnë një grup apo një bashkësi njerëzish, të akuzuarit duhet t’i jepet sa më shumë informacion i hollësishëm në lidhje me: vendngjarjet, kohën dhe numrin e përafërt të viktimave; hollësitë e nevojshme për të kuptuar elementet e krimeve, si veprimtari e pretenduar e të akuzuarve që u bë shkas për përgjegjësinë penale të tyre, përfshirë konturet e planit ose qëllimit të përbashkët, zbatimin e tij, si edhe kontributin e të akuzuarve në të; elementin mendor të lidhur me të; dhe identitetet e bashkëkryesve të pretenduar ose anëtarëve të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët (NKP), nëse ka dhe në qoftë se dihen.⁴⁹

⁴⁶ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 30, me referenca të mëtejshme.

⁴⁷ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 31, me referenca të mëtejshme; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 16.

⁴⁸ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 31, me referenca të mëtejshme; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 16.

⁴⁹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 32, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 41; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 17.

31. Sa i takon përcaktimit të identitetit të viktimave, lloji dhe pesha e veprave penale të pretenduara mund ta bëjë të pamundur një përcaktim të tillë.⁵⁰ Në këto raste, mjafton identifikimi i viktimave si grup, apo numri i përafërt i tyre.⁵¹

32. Kur nuk mund të përcaktohet identiteti faktik i bashkëkryesve apo i anëtarëve të NKP-së, ata mund të identifikohen përmes një pseudonimi,⁵² përkatësie,⁵³ ose një grupi të përcaktuar prej parametrave gjeografikë, kohorë ose të tjerë.⁵⁴ Gjithsesi, nuk ekziston asnjë kusht për t'i identifikuar të gjithë individët e përfshirë në veprat penale që nuk konsiderohen si bashkëkryes të veprave të përfshira në aktakuzë apo si anëtarë të NKP-së.⁵⁵

33. Kur pretendohet se i akuzuari ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e një krimi, aktakuza duhet të identifikojë veprimet ose praktikën konkrete të sjelljes së të akuzuarit që përbën bazën e akuzave të përfshira në aktakuzë.⁵⁶

34. Nuk lejohen formulime të papërcaktuara në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat (të tilla si “përfshirë, ndër të tjera”),⁵⁷ veçse kur janë të nevojshme në raste të veçanta në bazë të rrethanave të çështjes apo të llojit dhe peshës së veprave penale dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat.⁵⁸

⁵⁰ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 34, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 43.

⁵¹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 34, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 43.

⁵² Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 35, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

⁵³ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 35, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

⁵⁴ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 35, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

⁵⁵ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 35, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

⁵⁶ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 36, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 53; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 42.

⁵⁷ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 84; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 44; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 17.

⁵⁸ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 84; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 44.

Informacioni duhet përshkruar me saktësi dhe plotësi, pa u shpërndarë.⁵⁹ Gjithashtu, kur përcaktohet një kategori e caktuar në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat dhe kur përdoret fjala “përfshirë” për të dhënë një listë shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, përdorimi i fjalës “përfshirë” lejohet.⁶⁰ Sidoqoftë, kur kategoria nuk përcaktohet, por vetëm i referohet një liste shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, paraprirë nga fjala “përfshirë”, një përdorim i tillë i fjalës “përfshirë” nuk lejohet, sepse do të mundësonte në mënyrë të palejueshme që fushëveprimi i kategorisë përkatëse të zgjerohej në fazën e gjykimit.⁶¹

35. Lejohen formulime alternative të tilla si “dhe/ose” në qoftë se kanë lidhje me provat që do të shqyrtohen në gjykim,⁶² dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat ose me format e përgjegjësisë penale.⁶³

3. Aktakuzë me mangësi

36. Aktakuza ka mangësi kur nuk paraqet faktet mbi të cilat mbështeten akuzat, apo kur i paraqet ato në mënyrë të pamjaftueshme apo të paqartë, duke krijuar paqartësi lidhur me akuzat e parashtruara, përfshirë edhe format e përgjegjësisë, dhe duke dëmtuar mundësinë e Mbrojtjes për t’u përgatitur.⁶⁴

37. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se konstatimet e lartpërmendura do të jenë informuese dhe udhëzuese për vlerësimin e mëposhtëm të mangësive të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar.

⁵⁹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39, me referenca të mëtejshme; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 10.

⁶⁰ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39.

⁶¹ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39.

⁶² Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45, me referenca të mëtejshme.

⁶³ Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45, me referenca të mëtejshme.

⁶⁴ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 40, me referenca të mëtejshme; Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 38; Vendimi mbi Mocionet Paraprake *Gucati dhe Haradinaj*, para. 46.

B. AKUZAT E SHUMËFISHTA

38. Mbrojtja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi duke qenë se e akuzon z. Shala për ndalim arbitrar (pika 1), trajtim mizor (pika 2) dhe torturë (pika 3) dhe këto pika janë paraqitur si kumulative, dhe jo si alternative.⁶⁵ Mbrojtja pretendon se akuzat e shumëfishta i ngarkojnë Mbrojtjes një barrë të tepërt, cenojnë një sërë të drejtash për gjykim të drejtë dhe do të zgjasin gjykimin në mënyrë të panevojshme.⁶⁶ Duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare ("GJPN"), Mbrojtja parashtron se akuzat e shumëfishta mund të përlligjen vetëm në rastet e krimeve të ndryshme që mbrojnë vlera të ndryshme dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të tregojë kujdes në këtë aspekt.⁶⁷

39. Në lidhje me pikat 1 dhe 2, Mbrojtja parashtron se Pika 1 (ndalim arbitrar), siç argumentohet nga ZPS-ja, përfshihet kryesisht në Pikën 2 (trajtim mizor), që është cilësimi ligjor më i përshtatshëm për faktet e parashtruara.⁶⁸ Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja parashtron se akuzat e shumëfishta të Pikave 2 dhe 3, përkatësisht trajtimi mizor dhe tortura, shkelin parimin e veprës penale më pak të përfshirë dhe parimin e konsumimit.⁶⁹ Si alternativë, Mbrojtja kundërshton Pikat 2 dhe 3 duke qenë se në secilën pikë pretendohet më shumë se një vepër penale.⁷⁰

40. Mbrojtja arrin në përfundimin se lënia e marrjes së vendimit në lidhje me akuzat e shumëfishta për në gjykim dëmton përgatitjen e saj dhe të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë, veçanërisht në rrethanat aktuale kur Mbrojtja është e detyruar të

⁶⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në paragrafin 14 të Mocionit të Mbrojtjes, Mbrojtja parashtron se Pikat 1-4 janë palejueshmërisht kumulative. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta trajtojë këtë argument vetëm në lidhje me pikat 1-3 duke pasur parasysht faktin që Mbrojtja shtjellon argumentet e saj vetëm në lidhje me këto pika.

⁶⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 14-15, 18.

⁶⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 16-17.

⁶⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 19-22.

⁶⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 23-24.

⁷⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 25.

punojë me mjete të pakta.⁷¹ Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të mos lejojë akuzat e shumëfishta.⁷²

41. ZPS-ja përgjigjet se tribunalët *ad hoc* kanë lejuar akuzat e shumëfishta dhe vendimi i GJPN-së në të cilin mbështetet Mbrojtja duhet të interpretohet në kuadër të veçorive të kornizës ligjore të GJPN-së.⁷³ Gjithsesi, ZPS-ja parashton se GJPN-ja gjithashtu ka konstatuar kohët e fundit se akuzat e shumëfishta mund të trajtohen më mirë në gjykim.⁷⁴

42. Për sa u përket kundërshtimeve konkrete të paraqitura nga Mbrojtja, ZPS-ja argumenton se ndalimi arbitrar dhe trajtimi mizor përmbajnë secili një element që është i dallueshëm nga tjetri dhe, për rrjedhojë, përmbushin parimin e specialitetit reciprok. ZPS-ja shton se, ndonëse është e vërtetë që çdo akt torture cilësohet si trajtim mizor, e anasjellta nuk është e vërtetë.⁷⁵

43. Mbrojtja kundërpërgjigjet se DHS-ja nuk duhet të ndjekë automatikisht praktikat dhe jurisprudencën e gjykatave të tjera dhe duhet të marrë parasysh që akuzat e shumëfishta shpesh çojnë në procese të tejzgjatura.⁷⁶ Megjithëse Mbrojtja pranon se vendimi i GJPN-së në të cilin është mbështetur duhet të interpretohet në kuadër të kornizës ligjore të GJPN-së, ajo parashton se ky vendim në bazë të tij kishte padrejtësinë e vetvetishme të akuzave të shumëfishta.⁷⁷ Së fundi, Mbrojtja parashton se, duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ"),⁷⁸ është e nevojshme të mbrohet i akuzuari nga rreziku i dëmtimit të tij që buron nga shtyrja e trajtimit të çështjes së akuzave të shumëfishta për në gjykim.⁷⁹

⁷¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 26.

⁷² Mocioni i Mbrojtjes, para. 14.

⁷³ Përgjigjja, para. 14-17.

⁷⁴ Përgjigjja, para. 18-19.

⁷⁵ Përgjigjja, para. 21-23.

⁷⁶ Kundërpërgjigjja, para. 8.

⁷⁷ Kundërpërgjigjja, para. 6-7.

⁷⁸ Kundërpërgjigjja, para. 10-11.

⁷⁹ Kundërpërgjigjja, para. 9, 12-14.

44. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se as Ligji dhe as Rregullorja nuk përmbajnë dispozita që ndalojnë mundësinë e përdorimit të cilësimeve të ndryshme ligjore për të njëjtat vepra në një aktakuzë, p.sh. akuzat e shumëfishta.

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej thekson se gjykata të ndryshme ndërkombëtare kanë lejuar vazhdimisht akuza të shumëfishta nga prokuroria. Më konkretisht, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) fillimisht konstatoi se lejohet ngritja e akuzave të shumëfishta duke pasur parasysh faktin se përpara paraqitjes të të gjitha provave, nuk është e mundur të përcaktohet me siguri se cila prej akuzave të ngritura kundër një të akuzuari do të vërtetohet.⁸⁰ Ky parim është mbështetur vazhdimisht, ndër të tjera, nga tribunalët *ad hoc*,⁸¹ Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (“DHJGJK”),⁸² Gjykata Speciale për Sierra Leonen (“GJSSL”)⁸³ dhe, me disa rezerva, nga Tribunali Special për Libanin (“TSL”).⁸⁴ Ndonëse është e vërtetë që GJPN-ja, siç parashtron Mbrotjtja, fillimisht nuk u pajtua me këtë praktikë,⁸⁵ ajo së fundmi ka lejuar akuzat e shumëfishta nga prokuroria.⁸⁶

⁸⁰ ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Čelebići Appeals Judgment”), 20 February 2001, para. 400.

⁸¹ ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Appeal Judgement](#), 23 October 2001, paras 385-386; *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 3 May 2006, para. 103; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, [Judgement](#), 12 June 2002, para. 167; ICTR, *Prosecutor v. Rutaganda*, ICTR-96-3-T, Trial Chamber I, [Judgement and Sentence](#), 6 December 2009, para. 116; *Prosecutor v. Kanyabashi*, ICTR-96-15-I, Trial Chamber II, [Decision on Defence Preliminary Motion for Defects in the Form of the Indictment](#), 31 May 2000, paras 5.5-5.7.

⁸² *Shih*, për shembull, ECCC, *Prosecutor v. Kaing Guek Eav (“Duch”)*, 001/18-07-2007-ECCC/OCIJ (PTC 02), Pre-Trial Chamber, [Public Decision on Appeal against Closing Order Indicting Kaing Guek Eav alias “Duch” \(“Duch Appeal against Closing Order”\)](#), 5 December 2008, paras 85-88.

⁸³ SCSL, *Prosecutor v. Brima et al.*, SCSL-2004-16-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 22 February 2008, para. 212, footnote 327.

⁸⁴ STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I, Appeals Chamber, [Interlocutory Decision on the Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging](#), 16 February 2011, paras 265-301.

⁸⁵ ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-424, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Bemba Gombo](#), 15 June 2009, paras 200-205.

⁸⁶ ICC, *Prosecutor v. Alfred Yekatom and Patrice-Edouard Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-403-Red-Corr, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Corrected version of “Decision on the confirmation of charges against Alfred Yekatom and Patrice-Edouard Ngaïssona” \(“Yekatom and Ngaïssona Confirmation Decision”\)](#), 14 May 2020,

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se neni 39(2) i Ligjit e autorizon atë të refuzojë të konfirmojë aktakuzën vetëm kur provat e ofruara nga ZPS-ja nuk mbështesin dyshimin e bazuar mirë se personi ka kryer veprën penale të përfshirë në aktakuzë, dhe jo mbi bazën e preferencës së një cilësimi ligjor të mundshëm ligjor të fakteve ndaj një cilësimi tjetër, po aq të mundshëm.

47. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se i takon Trupit Gjykses të vlerësojë plotësisht rrethanat përkatëse dhe të zgjidhë çështjen e njëkohshmërisë së veprave penale, pas paraqitjes së provave.⁸⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se para paraqitjes së të gjitha provave në gjykim, ZPS-ja duhet të ketë mjetet për t'i paraqitur akuzat në një mënyrë të tillë që do t'i mundësonte Trupit Gjykses të ardhshëm të vendoste për akuzat më të përshtatshme, bazuar në mjaftueshmërinë e provave.

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i vetëdijshëm se, siç parashtron Mbrojtja, akuzat e shumëfishta mund të cenojnë të drejtat për gjykim të drejtë të të akuzuarit, ndër të cilat e drejta për kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij ose e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, dhe mund t'i vendosin një barrë Mbrojtjes për sa i përket ngarkesës së punës.⁸⁸ Megjithatë, në çështjen aktuale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja nuk i konkretizon këto argumente në detaje dhe për çështjen në fjalë, por thjesht parashtron, në terma të përgjithshme, se është provuar se praktika e akuzave të shumëfishta të papërshtatshme ka pasur një efekt negativ ndaj një sërë të drejtash të të akuzuarve dhe e ka ngarkuar Mbrojtjen me një barrë të palejueshme.⁸⁹

paras 120-121; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-422-Red, [Decision on the Confirmation of Charges against Dominic Ongwen](#), 23 March 2016 (“Ongwen Confirmation Decision”), paras 31-33.

⁸⁷ *Për ngjashmëri*, ICTY, [Čelebići Appeals Judgment](#), para. 400; ICC, [Yekatom and Ngaïssona Confirmation Decision](#), para. 121; [Ongwen Confirmation Decision](#), paras 30, 33.

⁸⁸ *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Judgment](#), 14 January 2000, paras 724-725.

⁸⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 18; Kundërpërgjigjja, para. 8.

49. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se shqetësimet e Mbrojtjes për rrezikun “shumë real” të dëmtimit të të akuzuarit⁹⁰ lidhen vetëm me konceptin tjetër të dënimeve të shumëfishta, i cili nuk ka lidhje me çështjen nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta lejojë ZPS-në të akuzojë z. Shala për të njëjtin grup faktesh sipas cilësimeve të ndryshme ligjore.⁹¹

50. Po kështu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përmendja nga Mbrojtja e nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së është e pavend, pasi ky i fundit ndalon përsëritjen e procesit penal për një veprë për të cilën një person është shpallur i pafajshëm ose fajtor dhe nuk trajton problemin e një grupi faktesh që mund të përbëjnë vepra të ndryshme penale në të njëjtin proces penal. Cilësimet e ndryshme ligjore për të njëjtat vepra në një aktakuzë nuk kërcënojnë vetvetiu parimin *ne bis in idem* sepse nuk përfshijnë përcaktimin e përgjegjësisë penale apo dënimin aktual.⁹²

51. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me akuzat e shumëfishta.

ARGUMENTIMI I FORMAVE TË PËRGJEGJËSISË PENALE

1. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

52. Mbrojtja parashtron se argumentimi i NKP-së në Aktakuzën e Konfirmuar është i mjegullt dhe, për rrjedhojë, i mangët.⁹³ Gjithashtu, Mbrojtja rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka pranuar më parë se në këtë çështje gjyqësore ka një numër të vogël anëtarësh të NKP-së (“Anëtarët e NKP-së”) dhe, si rrjedhim, nuk ka asnjë justifikim për mungesën e qartësisë dhe fakteve materiale që mbështesin akuzat e ZPS-së.⁹⁴

⁹⁰ Kundërpërgjigja, para. 9.

⁹¹ ICC, [Ongwen Confirmation Decision](#), para. 30.

⁹² ECCC, [Duch Appeal against Closing Order](#), para. 88.

⁹³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 37.

⁹⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 36.

a) Anëtarësimi në NKP

53. Mbrojtja pretendon se, duke pasur parasysh shkallën e NKP-së dhe ngjarjet kryesore, identiteti dhe roli i anëtarëve të pretenduar të NKP-së dhe instrumenteve të tyre – d.m.th. i individëve që nuk ishin anëtarë të NKP-së, por pretendohet se u përdorën nga anëtarët e NKP-së për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (“Instrumentet”) – është palejueshmërisht i mjegullt.⁹⁵ Duke pretenduar se detyrimi për konkretësi më të madhe lind për shkak të afërsisë së z. Shala me vendngjarjet e kryerjes fizike të krimeve të përfshira në Aktakuzë, Mbrojtja argumenton se fraza “disa ushtarë, policë dhe roja të tjerë [të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”)] të pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës” është shumë e mjegullt dhe ZPS-ja duhet të urdhërohet të bëjë të ditur nëse dihen apo jo emrat e anëtarëve të tjerë.⁹⁶

54. ZPS-ja përgjigjet se anëtarët e NKP-së dhe instrumentet e tyre janë identifikuar sipas emrit dhe/ose pseudonimit, përkatësisë, vendndodhjes kohore dhe gjeografike, dhe rolit ose pozitës në Aktakuzën e Konfirmuar dhe se një nivel i tillë identifikimi është në përputhje me shkallën e ngjarjeve.⁹⁷

55. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar argumenton se, përveç z. Shala, anëtarë të tjerë të NKP-së ishin edhe Sabit Geci me pseudonimin “Qopa”, Xhemshit Krasniqi, ushtarët e UÇK-së me pseudonimet [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe disa ushtarë, policë dhe roje të tjera të UÇK-së, të pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës.⁹⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se Aktakuza e Konfirmuar identifikon pesë anëtarë të NKP-së, duke përfshirë të akuzuarin. Anëtarët e tjerë të NKP-së së pretenduar janë identifikuar si “disa

⁹⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 39.

⁹⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 40-41, 56.

⁹⁷ Përgjigjja, para. 30.

⁹⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 10.

ushtarë, policë dhe roja të tjerë të UÇK-së”. Ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake më herët ka konstatuar se përmasat e NKP-së në çështjen gjyqësore aktuale janë relativisht të vogla dhe se ngjarjet ku mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme,⁹⁹ kjo nuk nënkupton që gjuha e përdorur nga ZPS-ja është palejueshmërisht e mjegullt. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se aktakuza duhet t’i identifikojë anëtarët e NKP-së të paktën sipas kategorisë ose grupit.¹⁰⁰ Aktakuza e Konfirmuar, pasi identifikon konkretisht pesë anëtarët e NKP-së, u referohet qartë tre kategorive të ndryshme të personave dhe kufizon qartë shtrirjen gjeografike të NKP-së duke përcaktuar se ata persona ndodheshin tek fabrika e metalit në Kukës brenda një periudhe të caktuar kohe, nga 17 maji 1999 deri më 5 qershor 1999.¹⁰¹

56. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i frazës “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” në çështjen aktuale nuk është palejueshmërisht i mjegullt duke parë se anëtarët e NKP-së janë identifikuar si ushtarë, policë dhe roje të pranishëm në një vend të caktuar gjatë një periudhe të caktuar kohe.

57. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh afërsinë e pretenduar të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se anëtarësimi i tij në NKP-në e pretenduar është argumentuar me konkretësi të mjaftueshme. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me anëtarësimin e tij në NKP.

b) Përkufizimi i instrumenteve

58. Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk bën dallimin ndërmjet anëtarëve të NKP-së dhe instrumenteve, por i përdor këto terma përkëmbyeshmërisht, pa specifikuar

⁹⁹ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial, para. 26. Versioni i redaktuar publik u nxor më 23 qershor 2021, F00045/RED.

¹⁰⁰ *Shih* Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45.

¹⁰¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 8.

identitetet dhe rolet e tyre përkatëse.¹⁰² Duke pretenduar se një mungesë e tillë konkretësie dëmton vetvetiu z. Shala, Mbrojtja parashtron se ai po ngarkohet me përgjegjësi penale që buron nga veprimet e të tjerëve, dhe në veçanti nga një numër i pacaktuar anëtarësh të panjohur dhe të paidentifikueshëm.¹⁰³

59. ZPS-ja përgjigjet se lejohet të pretendohet që persona të caktuar të jenë anëtarë të NKP-së ose instrumente, nëse kjo bëhet duke përdorur argumentime alternative. ZPS-ja më tej argumenton se Mbrojtja nuk është dëmtuar pasi është vënë në dukje se, në qoftë se për disa prej anëtarëve të pretenduar të NKP-së konstatohet se nuk kanë qenë anëtarë, ZPS-ja pretendon se ata kanë vepruar si instrumente.¹⁰⁴ Së fundi, ZPS-ja përgjigjet se pretendimi i Mbrojtjes se përgjegjësia penale e z. Shala buron nga veprimet e një “numri të pacaktuar anëtarësh të panjohur dhe të paidentifikueshëm” nuk është kundërshtim për formën e Aktakuzës së Konfirmuar.¹⁰⁵

60. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, pasi identifikon anëtarët e NKP-së, Aktakuza e Konfirmuar thekson se këta anëtarë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët.¹⁰⁶ Më tej vërehet se, si alternativë, Aktakuza e Konfirmuar argumenton se disa ose të gjithë këta persona nuk kanë qenë anëtarë të NKP-së, por janë përdorur nga anëtarët e NKP-së për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët.¹⁰⁷ Rrjedhimisht, Aktakuza e Konfirmuar i përkufizon instrumentet në lidhje me të njëjtët individë, kategori dhe grupe si edhe anëtarët e NKP-së, për të cilët Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se janë paraqitur me konkretësi të mjaftueshme.¹⁰⁸

61. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-së i lejohet të argumentojë se të gjithë ose disa nga personat e përmendur në paragrafin 10 të Aktakuzës së

¹⁰² Mocioni i Mbrojtjes, para. 42.

¹⁰³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 43.

¹⁰⁴ Përgjigjja, para. 31.

¹⁰⁵ Përgjigjja, para. 32.

¹⁰⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 10.

¹⁰⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 10.

¹⁰⁸ *Shih* para. 55-57 më lart.

Konfirmuar ishin anëtarë ose instrumente të NKP-së, nëse e argumenton këtë në alternativë. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se argumentimi alternativ lejohet dhe është, në fakt, një praktikë mjaft e njohur në gjykatat penale ndërkombëtare.¹⁰⁹ I takon Trupit Gjykues të marrë vendim për këtë pas paraqitjes së të gjitha provave. Në funksion të informimit të të akuzuarit për akuzat e ngritura, Mbrojtja paralajmërohet se, në qoftë se për disa prej anëtarëve të pretenduar të NKP-së konstatohet se nuk kanë qenë anëtarë, për ta gjithësi pretendohet se kanë qenë instrumente.

62. Së fundi, për sa i takon parashtrimin të Mbrojtjes se z. Shala akuzohet për një formë të përgjegjësive penale që bazohet në fajësimin për veprimtari kriminale të një numri të pacaktuar anëtarësh të panjohur dhe të pidentifikueshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pasi ka përcaktuar se identiteti i anëtarëve të NKP-së dhe instrumenteve të tyre është paraqitur saktë,¹¹⁰ ky parashtrim nuk ka nevojë të trajtohet më tej.¹¹¹ Sidoqoftë, një kundërshtim i tillë lidhet me elementet ligjore të kësaj forme përgjegjësie dhe, për rrjedhojë, nuk përbën kundërshtim për formën e aktakuzës.¹¹² Si rrjedhim, ky parashtrim hidhet poshtë.

63. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me përkufizimin e instrumenteve.

c) Kontributi i të akuzuarit në NKP

64. Mbrojtja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar nuk arrin të demonstrojë se në çfarë rrethanash z. Shala dha kontribut të qenësishëm në NKP dhe se ai ka të drejtë të informohet në mënyrë të qartë dhe të saktë për veprimet konkrete të pretenduara që i

¹⁰⁹ Për ngjashmëri, Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 82, me referenca të mëtejshme.

¹¹⁰ *Shih* para. 55-57 më lart.

¹¹¹ *Shih gjithashtu*, Vendimi në lidhje me Juridiksionin, para. 94.

¹¹² *Shih* para. 28 më lart.

ngarkohen.¹¹³ Mbrojtja argumenton se Aktakuza e Konfirmuar nuk identifikon asnjë veprim ose mosveprim konkret të kryer nga z. Shala, me anë të të cilit pretendohet se ai dha kontribut të qenësishëm në NKP. Më konkretisht, Mbrojtja identifikon mangësitë e mëposhtme, që rrjedhin nga përkrahjet e përgjithshme të veprimtarisë së pretenduar, pa iu referuar ndonjë incidenti konkret, që, sipas mendimit të saj, rrezikon përgatitjen e mbrojtjes: (i) përkrahja e përgjithshme e pjesëmarrjes së z. Shala, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, në transferimin e një personi në fabrikën e metalit në Kukës, siç përkrahjet në paragrafin 15 të Aktakuzës së Konfirmuar;¹¹⁴ (ii) përdorimi i frazës “ndër të tjera” në paragrafin 16 të Aktakuzës së Konfirmuar;¹¹⁵ (iii) pretendimi i përgjithshëm se z. Shala nuk mori masa për parandalimin ose kufizimin e dhunës ndaj të ndaluarve, ose ndryshe për të ndihmuar ose për të siguruar trajtim njerëzor të të ndaluarve;¹¹⁶ (iv) përkrahja e përgjithshme e tre incidenteve në të cilat pretendohet se z. Shala mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës;¹¹⁷ dhe (v) përdorimi i frazës “ndër të tjera” dhe të shprehjes “dhe/ose” në paragrafin 11 (c)-(d) të Aktakuzës së Konfirmuar.¹¹⁸

65. ZPS-ja përgjigjet se paragrafi 11 i Aktakuzës së Konfirmuar u referohet mënyrave të shumta me anë të të cilave i akuzuari ka dhënë kontribut në realizimin e qëllimit të përbashkët, duke përfshirë përdorimin e numrave të paragrafëve që u referohen incidenteve konkrete.¹¹⁹ Në veçanti, ZPS-ja parashton se Aktakuza e Konfirmuar përkrahjet me hollësi veprimtarinë e të akuzuarit dhe identifikon një sërë ngjarjesh, veprimesh ose mosveprimesh të të akuzuarit, ose të atyre që kanë kryer krime bashkë

¹¹³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44.

¹¹⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44.

¹¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44.

¹¹⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44.

¹¹⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44; *shih* gjithashtu para. 56, në fund, para. 57, para 64(β), që i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, paragrafi 22 (cilët ishin “disa anëtarë të UÇK-së” që detyruan [REDAKTUAR] të ndaluarit të [REDAKTUAR] dhe shtinë kundër tyre), 23 (cilët janë “anëtarët e UÇK-së” që vazhduan t’i rrihnin mizorisht megjithëse ishin të plagosur me armë zjarri).

¹¹⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 59.

¹¹⁹ Përgjigjja, para. 33.

me të kundër disa të ndaluarve.¹²⁰ ZPS-ja më tej parashtron se përdorimi i frazës “ndër të tjera” nuk krijon paqartësi ose rrezik që ZPS-ja t’i zgjerojë akuzat e saj përtej fushëveprimit të miratuar.¹²¹ Së fundi, ZPS-ja argumenton se përdorimi i “dhe/ose” në lidhje me format e përgjegjesisë penale nuk krijon paqartësi të palejueshme.¹²²

66. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar pretendon se z. Shala ka dhënë kontribut në realizimin e qëllimit të përbashkët të NKP-së, ndër të tjera, duke marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose duke kontribuar në krimet për të cilat ngrihen akuzat.¹²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se rastet në të cilat pretendohet se ka marrë pjesë personalisht apo ka kontribuar i akuzuari, duhet të paraqiten në mënyrë shteruese.¹²⁴ Mosparaqitja e tyre, e pjesshme apo tërësore, do të thotë që i akuzuari nuk është informuar (plotësisht) për veprimtarinë prej nga pretendohet se rrjedh përgjegjësia e tij penale. Kjo mund të dëmtojë aftësinë e tij për t’u vetëmbrojtur.¹²⁵

67. Duke iu kthyer kundërshtimeve konkrete të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafi 11 i Aktakuzës së Konfirmuar thekson se z. Shala ka marrë pjesë në akte të trajtimit mizor dhe torturës, ndër të cilat pretendimet e përfshira në paragrafët 20-23 të saj. Nga ana tjetër, paragrafët 22 dhe 23 të Aktakuzës së Konfirmuar përshkruajnë dy incidente të trajtimit mizor të pretenduar të [REDAKTUAR]. Në paragrafin 22, pasi pretendon se “[...] Pjetër Shala rrahu [REDAKTUAR]”, ZPS-ja parashtron se “disa anëtarë të UÇK-së më pas i detyruan këta dy të ndaluar që [REDAKTUAR] dhe shtinë kundër tyre me armë automatike, duke i plagosur të dy”.

¹²⁰ Përgjigjja, para. 33.

¹²¹ Përgjigjja, para. 40.

¹²² Përgjigjja, para. 41.

¹²³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 11.

¹²⁴ *Shih* Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 91.

¹²⁵ Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 91, me referenca të mëtejshme.

68. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake , ndërsa në fjalinë e parë parashtrohet në mënyrë të qartë se z. Shala ka marrë pjesë personalisht në incident, formulimi që përmban fjalia e dytë është i paqartë dhe nuk i lejon Mbrojtjes të kuptojë nëse pretendohet që z. Shala ishte ndër ata “disa anëtarë të UÇK-së” apo jo dhe nëse pretendohet se ai mori pjesë personalisht në incident.

69. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej thekson se i njëjti incident përmendet edhe në paragrafin 28 të Aktakuzës së Konfirmuar, ku, nga ana tjetër, saktësohet qartë se z. Shala ishte i pranishëm kur [REDAKTUAR] të ndaluarit u detyruan të [REDAKTUAR] dhe u qëlluan me armë automatike.¹²⁶ Për të shmangur çdo paqartësi, në lidhje me incidentin e përmendur në fjalinë e dytë të paragrafit 22 dhe fjalinë e parë të paragrafit 28 të Aktakuzës së Konfirmuar, ZPS-ja urdhërohet të sqarojë nëse po argumenton se z. Shala ka marrë pjesë personalisht në të apo jo, dhe, nëse jo, nëse gjithsesi ai ka qenë i pranishëm.

70. Sa i përket paragrafit 23 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja parashtron se:

Më [REDAKTUAR], ose rreth [REDAKTUAR], Pjetër Shala [...] dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, [...] morën në pyetje dhe rrahën [REDAKTUAR], ndër të tjera me shufra metalike, shkopiinj bejsbolli dhe armë. Ndërkohë që rrahjet vazhduan gjatë natës, anëtarët e UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtim shtinë me armë zjarri dhe i plagosën këta të ndaluar. [REDAKTUAR] të ndaluarit vazhduan të rriheshin mizorisht, megjithëse të plagosur me armë zjarri, [REDAKTUAR].

71. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, formulimi që përmban fjalia e dytë dhe e tretë e paragrafit 23 të Aktakuzës së Konfirmuar është i paqartë dhe nuk i lejon Mbrojtjes të kuptojë nëse pretendohet se z. Shala ishte ndër ata “anëtarë të UÇK-së” apo jo. Në veçanti, ndërsa fjalia e parë i referohet z. Shala dhe disa bashkëkryesve të tjerë, fjalia e dytë dhe e tretë i referohen vetëm anëtarëve të UÇK-së

¹²⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 28.

në përgjithësi. Rrjedhimisht, nuk është mjaftueshëm e qartë nëse pretendohet se z. Shala ka marrë pjesë personalisht në incidentet e lartpërmendura apo jo.

72. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se i njëjti nivel paqartësie përshkon edhe pjesët përkatëse të paragrafit 28 të Aktakuzës së Konfirmuar,¹²⁷ të cilat përshkruajnë të njëjtat incidente të përmendura në pjesën e lartpërmendur të paragrafit 23 të Aktakuzës së Konfirmuar.¹²⁸ Gjithashtu, ndërsa në fjalinë e parë të paragrafit 23 të Aktakuzës së Konfirmuar, ZPS-ja parashtron se z. Shala, individualisht dhe në bashkëpunim me persona të tjerë, mori në pyetje dhe rrahu [REDAKTUAR], fjalia e dytë e paragrafit 28, e cila i referohet të njëjtit incident, shpreh dykuptimësi dhe nuk është mjaft e qartë nëse pretendohet se z. Shala mori pjesë personalisht në incident apo jo.

73. Duke përsëritur se rastet në të cilat i akuzuari ka marrë pjesë personalisht duhet të paraqiten në mënyrë shteruese në Aktakuzën e Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që, në lidhje me incidentet e përmendura në fjalinë e dytë dhe të tretë të paragrafit 23 dhe në fjalinë e dytë, të tretë dhe të katërt të paragrafit 28 të Aktakuzës së Konfirmuar, të sqarojë nëse pretendohet se z. Shala ka marrë pjesë personalisht në to apo jo, dhe, nëse jo, nëse gjithsesi ai ka qenë i pranishëm.

74. Sa u përket veprimeve/mosveprimeve të tjera të pretenduara të të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafi 11 i Aktakuzës së Konfirmuar përmend mënyra të shumta me anë të të cilave pretendohet se z. Shala ka kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët. Duke përshkruar këto veprime/mosveprime, paragrafi 11 u referohet paragrafëve të tjerë të Aktakuzës së Konfirmuar, përkatësisht paragrafëve 15-16, 20-23 dhe 26, të cilët përshkruajnë incidente konkrete. Gjykatësi i

¹²⁷ Fjalitë në fjalë janë riprodhim fjalë për fjalë i fjalisë së dytë dhe të tretë të paragrafit 23: “Ndërkohë që rrahjet vazhduan gjatë natës, anëtarët e UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtim shtinë me armë zjarri dhe i plagosën këta të ndaluar. [REDAKTUAR] të ndaluarit vazhduan të rriheshin mizorisht, megjithëse të plagosur me armë zjarri, [REDAKTUAR]”. *Shih gjithashtu* Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(δ), që i referohet paragrafit 28 të Aktakuzës së Konfirmuar (cilët janë “disa anëtarë të UÇK-së” që detyruan [REDAKTUAR] të [REDAKTUAR], shtinë kundër tyre me armë automatike dhe i rrahën mizorisht).

¹²⁸ *Shih gjithashtu* Mocioni i Mbrojtjes, para. 57 në fund.

Procedurës Paraprake vë në dukje se veprimet/mosveprimet e pretenduara, në varësi të konstatimeve të bëra më sipër, janë paraqitur me konkretësi të mjaftueshme (p.sh. transferimi i një personi nga një vend në tjetrin duke e kërcënuar me vdekje;¹²⁹ marrja në pyetje dhe keqtrajtimi fizik dhe psikologjik i të paktën [REDAKTUAR] të ndaluarve, duke përfshirë rrahjet me mjete të ndryshme;¹³⁰ kërcënimi i të ndaluarve dhe akuzat ndaj tyre për bashkëpunim me autoritetet serbe dhe/ose si mospërkrahës të UÇK-së¹³¹). Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se incidentet e përshkruara janë paraqitur me hollësi të mjaftueshme duke qenë se: (i) janë dhënë vendndodhjet e krimeve të pretenduara;¹³² (ii) janë dhënë datat konkrete;¹³³ dhe (iii) janë përmendur gjerësisht me emra bashkëkryesit dhe viktimat.¹³⁴ Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, nuk është e nevojshme që këto veprime të pretenduara të specifikohen më tej. E rëndësishme është se i akuzuari është informuar për sjelljen prej së cilës pretendohet se ka lindur përgjegjësia e tij penale. Për hollësitë e tjera përveç atyre që tashmë janë dhënë, do të vendoset në gjykim.

75. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kthehet kundërshtimit të Mbrojtjes se përdorimi i frazës “ndër të tjera” në paragrafët 11(d) dhe 16 të Aktakuzës së Konfirmuar është i mangët pasi argumenton në një mënyrë palejueshmërisht të pasaktë për raste të pjesëmarrjes personale të të akuzuarit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër të tjera” nuk ka për qëllim të japë shembuj joshterues në lidhje me një kategori të përcaktuar, por përdoret në të dyja rastet si një frazë e hapur që mund t’i lërë hapësirë ZPS-së të shtojë raste të tjera të pretenduara në gjykim, veç atyre që janë përshkruar shprehimisht në këta paragrafë. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se fraza “ndër të cilat” është përdorur në mënyrë të papërshtatshme edhe në paragrafin 11(a)-(b). Për rrjedhim, Gjykatësi i Procedurës

¹²⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 15.

¹³⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 21.

¹³¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 21.

¹³² Aktakuza e Konfirmuar, para. 15-16, 21. *Shih gjithashtu* para. 18 dhe 24.

¹³³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 15-16, 21-23, 28.

¹³⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 15-16, 21-23, 28.

Paraprake konstaton se kundërshtimi i Mbrojtjes ka njëfarë baze. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të paraqesë versionin e korigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar: (i) duke hequr frazat “ndër të cilat” në paragrafin 11 (a) dhe (b) dhe “ndër të tjera” në paragrafin 11 (d) të Aktakuzës së Konfirmuar; dhe (ii) duke hequr frazën “ndër të tjera” në paragrafin 16 të Aktakuzës së Konfirmuar.

76. Nga ana tjetër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i shprehjes “dhe/ose” në paragrafin 11(c) të Aktakuzës së Konfirmuar nuk krijon ndonjë paqartësi në lidhje me formën e përgjegjësisë penale të parashtruar në aktakuzë, pasi është përdorur nga ZPS-ja për të treguar se z. Shala mund të ketë kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët të NKP-së në më shumë se një nga mënyrat e renditura, për të cilën do të vendoset në gjykim.

77. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton, lidhur me konstatimet e paraqitura në paragrafët 69-73, dhe 75 më lart, Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me kontributin e pretenduar të të akuzuarit në realizimin e qëllimit të përbashkët. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon pjesën e mbetur të kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me kontributin e pretenduar të të akuzuarit në realizimin e qëllimit të përbashkët, pasi kjo është paraqitur me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar.

d) Argumentimi i formës së NKP-së

78. Mbrojtja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar nuk specifikon shprehimisht se cila formë e NKP-së pretendohet se ka ndodhur. Ajo është e mendimit se ky informacion duhet të jepet në Aktakuzën e Konfirmuar pasi është kyç për Mbrojtjen.¹³⁵

79. ZPS-ja përgjigjet se është mjaft e qartë se Aktakuza e Konfirmuar e ka vënë në dijeni të akuzuarin se argumentohet përgjegjësi penale për formën e parë të NKP-së

¹³⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 45.

(“NKP I”) për të gjitha krimet dhe për formën e tretë të NKP-së (“NKP III”) në lidhje me veprën penale të vrasjes së paligjshme, si alternativë ndaj NKP I.¹³⁶

80. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se në Aktakuzën e Konfirmuar parashtrohet qartë se i akuzuari kishte synimin e përbashkët të kryerjes së veprave penale të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, së bashku me anëtarët e tjerë të NKP-së.¹³⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është e qartë se ZPS-ja argumenton formën e NKP I në lidhje me këto vepra penale.¹³⁸ Si alternativë, në Aktakuzën e Konfirmuar parashtrohet se për të akuzuarin ishte e parashikueshme që vepra penale e vrasjes së paligjshme mund të kryhej nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së, ose nga persona të përdorur nga cilido prej anëtarëve të NKP-së, për të kryer krimet e përfshira në qëllimin e përbashkët, se ai ishte i vetëdijshëm se vrasja e paligjshme ishte pasojë e mundshme e realizimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së, dhe se ai mori pjesë në NKP dhe, për rrjedhim, mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë. Siç e pranon edhe vetë Mbrojtja,¹³⁹ është e qartë se, për krimin e vrasjes së paligjshme dhe si alternativë ndaj NKP I, ZPS-ja argumenton për një formë të NKP III.¹⁴⁰

81. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me formën e NKP-së së argumentuar.

2. Ndhurma dhe inkurajimi

82. Mbrojtja parashtron se Aktakuzës së Konfirmuar i mungojnë hollësitë e nevojshme në lidhje me veprimet dhe mosveprimet me anë të të cilave i akuzuari pretendohet se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e secilit krim të përfshirë në

¹³⁶ Përgjigjja, para. 34.

¹³⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 9.

¹³⁸ *Shih gjithashtu* Vendimi i Konfirmimit, para. 115-120.

¹³⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 35: “[...] ai është përgjegjës për vrasje të paligjshme në bazë të formës së tretë të NKP-së [...]”.

¹⁴⁰ *Shih gjithashtu* Vendimi i Konfirmimit, para. 121-124.

Aktakuzë dhe nuk identifikon personat që pretendohet se u ndihmuan nga z. Shala.¹⁴¹ Gjithashtu, Mbrojtja pretendon se ZPS-ja nuk përcakton konkretisht se si veprimet dhe mosveprimet e z. Shala patën një ndikim të konsiderueshëm mbi kryesit e pretenduar të veprave penale të përfshira në Aktakuzë dhe identitetet e tyre. Së fundi, Mbrojtja parashtron se përdorimi i frazës “dhe/ose” në paragrafët 11(c), 12 dhe 30 krijon paqartësi të papërligjur, pasi nuk është e qartë nëse z. Shala akuzohet për ndihmë dhe inkurajim si alternativë dhe kontributi i tij i pretenduar është paraqitur në mënyrë të pasaktë dhe të përgjithshme.¹⁴²

83. ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar nuk ka mangësi sepse ajo: (i) thekson se e gjithë baza faktike e NKP-së është përfshirë me anë të referencave edhe për sa i përket ndihmës dhe inkurajimit;¹⁴³ (ii) rendit disa veprime dhe kontribute, krahas përfshirjes së paragrafëve, që identifikojnë më tej individët që z. Shala pretendohet se ka ndihmuar dhe inkurajuar;¹⁴⁴ (iii) shkalla e hollësive të dhëna në lidhje me personat e ndihmuar është e mjaftueshme për informimin e Mbrojtjes;¹⁴⁵ (iv) për pasojat e veprimeve apo mosveprimeve të z. Shala do të vendoset në gjykim;¹⁴⁶ dhe (v) përdorimi i frazës “dhe/ose” në lidhje me këtë formë përgjegjësie penale nuk krijon paqartësi të palejueshme.¹⁴⁷

84. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në Aktakuzën e Konfirmuar thuhet qartë se “këtyre veprimeve dhe mosveprimeve” të paraqitura lidhur me përgjegjësinë penale për NKP-në përbëjnë bazën edhe për ndihmën dhe inkurajimin.¹⁴⁸ Duke rikujtuar se Aktakuza e Konfirmuar duhet lexuar si e tërë,¹⁴⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Aktakuza e Konfirmuar e bën të qartë se këto veprime dhe

¹⁴¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 47-48.

¹⁴² Mocioni i Mbrojtjes, para. 59.

¹⁴³ Përgjigjja, para. 35.

¹⁴⁴ Përgjigjja, para. 36.

¹⁴⁵ Përgjigjja, para. 37.

¹⁴⁶ Përgjigjja, para. 37.

¹⁴⁷ Përgjigjja, para. 41.

¹⁴⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 12.

¹⁴⁹ *Shih* para. 26 më lart.

mosveprime janë përfshirë me anë të referencave dhe ZPS-ja mbështetet në to kur argumenton ndihmën dhe inkurajimin. Pasi ka konstatuar se këto veprime dhe mosveprime, duke pasur parasysh konstatimet e bëra më sipër,¹⁵⁰ janë parashtruar me konkretësi të mjaftueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do ta trajtojë më tej këtë çështje.

85. Për sa i përket shkallës së hollësive të dhëna në lidhje me personat e ndihmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, aty ku pretendohet se i akuzuari planifikoi, nxiti, urdhëroi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve, ZPS-ja duhet së paku të identifikojë personat që pretendohet se janë ndihmuar ose nxitur nga i akuzuari sipas kategorisë, grupit ose përkatësisë, të cilat përbëjnë fakte materiale që duhet të argumentohen në Aktakuzë.¹⁵¹

86. Në këtë aspekt, paragrafi 12 i Aktakuzës së Konfirmuar thekson se “këtyre veprimeve dhe mosveprimeve” të paraqitura lidhur me përgjegjësinë penale për NKP-në përbëjnë bazën edhe për ndihmën dhe inkurajimin. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se çdo sjellje e përshkruar identifikon një kategori të personave të ndihmuar (anëtarë të UÇK-së, shpesh të identifikuar me emrat e tyre)¹⁵² dhe kufizon qartësisht shtrirjen gjeografike dhe kohore të ngjarjeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo është e mjaftueshme për të informuar Mbrojtjen dhe të gjitha hollësitë e tjera do të duhet të vlerësohen në gjykim.

87. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se lidhur me aspektin nëse veprimet dhe mosveprimet e pretenduara kanë pasur një ndikim thelbësor në kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë, do të vendoset në gjykim.¹⁵³

88. Sa i takon përdorimit të frazës “dhe/ose” në paragrafin 11(c) të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se zgjedhja e kësaj fraze nga

¹⁵⁰ *Shih* para. 69-73, dhe 75 më lart.

¹⁵¹ Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 53.

¹⁵² Aktakuza e Konfirmuar, para. 14-15, 18-19, 21-23, 26, 28.

¹⁵³ *Për ngjashmëri*, Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 111.

ZPS-ja nuk krijon ndonjë paqartësi në argumentim, nga njëra anë, se z. Shala ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë, duke kontribuar në këtë mënyrë në realizimin e qëllimit të përbashkët të NKP-së¹⁵⁴ dhe, në anën tjetër, që z. Shala, në alternativë, është përgjegjës për ndihmën dhe inkurajimin si formë përgjegjësie¹⁵⁵ Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se përmendja e ndihmës dhe inkurajimit në paragrafin 11(d) të Aktakuzës së Konfirmuar është bërë vetëm në lidhje me kontributin e tij në NKP dhe nuk përbën një akuzë të veçantë për ndihmë dhe inkurajim. Kjo për shkak se në paragrafin 12 të Aktakuzës së Konfirmuar është sqaruar se ndihma dhe inkurajimi (si një formë përgjegjësie penale për të cilën ngrihet akuzë e veçantë) është argumentuar veçmas në bazë të të njëjtave veprime, në tërësinë e tyre, siç pretendohet në lidhje me NKP-në.

89. Për sa i përket përdorimit të frazës “dhe/ose” në paragrafin 12 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk krijon ndonjë paqartësi në lidhje me formën e përgjegjësisë penale të parashtruar në Aktakuzë, pasi ajo është përdorur nga ZPS-ja për të ngritur pretendimin se z. Shala ka ndihmuar dhe inkurajuar në më shumë se një nga mënyrat e renditura, një çështje kjo për të cilën do të vendoset në gjykim.

90. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se përdorimi i frazës “dhe/ose” në paragrafin 30 të Aktakuzës së Konfirmuar nuk krijon ndonjë paqartësi pasi është e qartë se ZPS-ja po e argumenton ndihmën dhe inkurajimin, në alternativë, si një formë e veçantë e përgjegjësisë penale.¹⁵⁶ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

¹⁵⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 11(d).

¹⁵⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 12.

¹⁵⁶ *Shih gjithashtu* Vendimi i Konfirmimit, para. 125, në të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se “*si alternativë*” (theksimi i shtuar) ndaj përgjegjësisë së pretenduar për kryerje krimesh, në Aktakuzën e Rishikuar ZPS-ja pretendon se z. Shala është penalisht përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (pika 1), trajtimit mizor (pika 2), torturës (pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (pika 4), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.

rikujton se parashtrimi alternativ lejohet dhe është, në fakt, një praktikë mjaft e njohur në gjykatat penale ndërkombëtare.¹⁵⁷

91. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se forma e përgjegjësisë e ndihmës dhe inkurajimit paraqitet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar dhe rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt.

3. Kryerja fizike

92. Mbrojtja parashtron se argumentimi i kryerjes fizike në Aktakuzën e Konfirmuar është i mangët për arsyet e mëposhtme: paqartësia në lidhje me identitetin e bashkëkryesve, të cilët përmenden si “anëtarët e UÇK-së” ose “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” në paragrafët 14, 15, 22, 23 dhe 26 të Aktakuzës së Konfirmuar;¹⁵⁸

(ii) mungesa e qartësisë në lidhje me faktin nëse z. Shala ishte i pranishëm në incidentet e përshkruara në paragrafët 22 dhe 23 të Aktakuzës së Konfirmuar;¹⁵⁹ dhe

(iii) përdorimi i frazës “dhe/ose” në paragrafin 13 të Aktakuzës së Konfirmuar.¹⁶⁰

93. ZPS-ja përgjigjet se pretendimet se në Aktakuzën e Konfirmuar identiteti i kryesve të tjerë nuk është saktësuar mjaftueshëm, janë të pabaza duke qenë se Aktakuza e Konfirmuar, e lexuar si e tërë, i jep të akuzuarit informacion të mjaftueshëm dhe hollësitë e mëtejshme faktike në lidhje me identitetin e tyre do të trajtohen në gjykim.¹⁶¹ Sa i përket përdorimit të frazës “dhe/ose” në paragrafin 13 të Aktakuzës së Konfirmuar, ZPS-ja përgjigjet se përdorimi i saj mundëson shtjellimin faktik të çështjes në gjykim.¹⁶²

¹⁵⁷ *Për ngjashmëri, Vendimi në lidhje me Aktakuzën Thaçi dhe të tjerët*, para. 82, me referenca të mëtejshme.

¹⁵⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 51-54.

¹⁵⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 51-53

¹⁶⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 60.

¹⁶¹ Përgjigjja, para. 38-39.

¹⁶² Përgjigjja, para. 41, në fund.

94. Për sa i përket identitetit të bashkëkryesve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton parimin e përcaktuar sipas të cilit, në aktakuzë, Prokurorit të Specializuar i kërkohet të identifikojë bashkëkryesit, së paku, sipas kategorisë ose grupit dhe të japë identitetet konkrete të tyre, kur dihen.¹⁶³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se secila prej sjelljeve të përshkruara identifikon një kategori të bashkëkryesve (anëtarë të UÇK-së, të identifikuar shpesh me emra)¹⁶⁴ dhe kufizon qartësisht shtrirjen gjeografike dhe kohore të ngjarjeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo është e mjaftueshme për të informuar Mbrojtjen dhe të gjitha hollësitë e tjera do të duhet të vlerësohen në gjykim

95. Sa u përket rrethanave të pjesëmarrjes fizike të z. Shala në ngjarjet e përshkruara në paragrafët 22 dhe 23 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e bëra më lart në kontekstin e argumentimit të NKP-së.¹⁶⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ndryshimet që u urdhërua të bëhen do të trajtojnë kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me këtë formë të përgjegjesisë penale dhe, për rrjedhojë, nuk ka nevojë për një konstatim tjetër.

96. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i frazës “dhe/ose” në paragrafin 13 të Aktakuzës së Konfirmuar nuk krijon ndonjë paqartësi, pasi ZPS-ja parashtron se z. Shala synonte kryerjen e ndalimit arbitrar dhe, gjithashtu ose në alternativë, se ai veprroi me dijeni të arsyeshme se veprimi ose mosveprimi kishte gjasë të shkaktonte heqjen arbitrare të lirisë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kjo do të duhet të diskutohet në gjykim dhe Mbrojtja njoftohet se ZPS-ja po argumenton një formë alternative të synimit kriminal në lidhje me këtë vepër penale.

97. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në Aktakuzën e Konfirmuar kryerja fizike si formë përgjegjësie është argumentuar me

¹⁶³ Vendimi mbi Apelet *Gucati dhe Haradinaj*, para. 45.

¹⁶⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 14-15, 18-19, 21-23, 26.

¹⁶⁵ *Shih* para. 69-73 më lart.

qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme dhe rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt.

ARGUMENTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS

1. Elementet e përgjithshme të krimeve të luftës

98. Mbrojtja parashtron se argumentimi i elementeve të përgjithshme të krimeve të luftës është i mangët.¹⁶⁶ Në veçanti, Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk jep informacion të mjaftueshëm për lidhjen e nevojshme midis sjelljes së paraqitur në Aktakuzë dhe konfliktit të armatosur jondërkombëtar në fjalë ("KAJN").¹⁶⁷ Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton mungesën e informacionit konkret për statusin e viktimave dhe parashtron se Aktakuza e Konfirmuar duhej të kishte dhënë më shumë informacion në lidhje me rrethanat e tyre personale, statusin dhe lidhjet e tyre me forcat e përfshira në konflikt.¹⁶⁸

99. ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar, e lexuar si e tërë, ofron qartësi të mjaftueshme për periudhën e konfliktit të armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") dhe të Republikës së Serbisë, dhe për periudhën kur UÇK-ja përdori fabrikën e metalit në Kukës.¹⁶⁹ Sa i përket identitetit dhe rrethanave personale të viktimave të pretenduara, ZPS-ja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar përcakton qartë se këta ishin shtetas të RFJ-së dhe se ndër ta ishin së paku [REDAKTUAR] persona që ishin mbajtur të ndaluar në një vendndodhje konkrete gjatë një periudhe 20-ditore.¹⁷⁰

¹⁶⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 30-32.

¹⁶⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 30.

¹⁶⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 31-32.

¹⁶⁹ Përgjigjja, para. 25-26.

¹⁷⁰ Përgjigjja, para. 27.

100. Mbrojtja kundërpërgjigjet duke përsëritur se argumentimi i krimeve të luftës është i mangët dhe se “kriteri për ta lexuar aktakuzën si të tërë” nuk trajton në mënyrë të mjaftueshme mangësitë e identifikuar në Mocionin e Mbrojtjes.¹⁷¹

101. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja nuk e kundërshton Aktakuzën e Konfirmuar vetëm për sa i takon kriterit të lidhjes së krimeve të luftës me konfliktin e armatosur, por edhe në lidhje me ekzistencën e vetë konfliktit të armatosur jondërkombëtar.¹⁷²

102. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar thotë se: (i) në periudhën që ka lidhje me aktakuzën po zhvillohej një konflikt ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së, Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë;¹⁷³ (ii) krimet që paraqiten në këtë aktakuzë ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe në lidhje me këtë konflikt;¹⁷⁴ (iii) fabrika e metalit në Kukës u përdor si bazë e UÇK-së gjatë të gjitha periudhave që lidhen me këtë Aktakuzë për qëllime të ndryshme që lidhen me konfliktin e armatosur jondërkombëtar;¹⁷⁵ dhe (iv) krimet që paraqiten në këtë aktakuzë pretendohet se janë kryer ndërmjet 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999.¹⁷⁶ Rrjedhimisht, ekzistenca e konfliktit të armatosur dhe lidhja me të janë përshkruar me konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar.

103. Sa i përket statusit të viktimave të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në Aktakuzën e Konfirmuar thuhet qartë se viktimat e pretenduara ishin të gjithë shtetas të RFJ-së që nuk merrnin pjesë në luftime.¹⁷⁷ Në lidhje me identitetin e tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se mjafton identifikimi i viktimave si

¹⁷¹ Kundërpërgjigjja, para. 16-17.

¹⁷² *Shih* Mocioni i Mbrojtjes, para. 30.

¹⁷³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 3.

¹⁷⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 3.

¹⁷⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 6.

¹⁷⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 8-12, 14-16, 18-24, 26, 28.

¹⁷⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 6.

grup ose numri i përfaqësuesve të tyre.¹⁷⁸ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se Aktakuza e Konfirmuar, e lexuar si e tërë, jep informacion të mjaftueshëm për numrin e viktimave të pretenduara dhe informacion mjaftueshëm të qartë në lidhje me identitetin e tyre,¹⁷⁹ veçanërisht e shoqëruar me të dhënat që kanë të bëjnë me periudhën kohore dhe vendndodhjen ku pretendohet se janë kryer krimet, dhe veçori të tjera si shtetësia e viktimave,¹⁸⁰ përkatësia politike (e perceptuar),¹⁸¹ ose të dhëna të tjera në lidhje me vendin ku pretendohet se u kryen krimet.¹⁸² Rrjedhimisht çdo informacion tjetër në lidhje me përbërjen ose rrethanat personale të atij grupi ose asaj kategorie, ose në lidhje me statusin e viktimave në momentin e arrestimit të tyre, do të trajtohet në gjykim.

104. Së fundi, për sa i përket parashtrimit të Mbrojtjes se mbetet e paqartë nëse viktimat e pretenduara të arrestimeve ishin *jashtë luftimeve* në kohën e arrestimit të tyre,¹⁸³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 përmend persona *jashtë luftimeve*, ndër të tjera, për shkak të heqjes së lirisë. Rrjedhimisht, një person është *jashtë luftimeve* për shkak të një arrestimi. Për këtë arsye, nuk ka nevojë të demonstron se, në kohën e arrestimit, një person është *jashtë luftimeve*. Rrjedhimisht, parashtrimi i Mbrojtjes se Aktakuza e Konfirmuar është palejueshmërisht e mjegullt në këtë aspekt është i gabuar.

105. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se Aktakuza e Konfirmuar jep informacion të mjaftueshëm në lidhje me elementet kontekstuale që kanë lidhje me krimet e luftës. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në Aktakuzën e Konfirmuar elementet e përgjithshme të

¹⁷⁸ *Shih* para. 31 më lart.

¹⁷⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 14, 21-23, 28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se [REDAKTUAR] të ndaluar janë identifikuar me emër dhe [REDAKTUAR] është identifikuar si një "[REDAKTUAR] ndaluar".

¹⁸⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 6.

¹⁸¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 6, 21.

¹⁸² Aktakuza e Konfirmuar, para. 6, 14, 18-19.

¹⁸³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 32.

krimeve të luftës janë paraqitur me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme dhe rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt.

2. Ndalimi i paligjshëm/arbitrar, trajtimi mizor, tortura dhe vrasja e paligjshme

106. Mbrojtja kundërshton duke parashtruar se argumentimi i krimeve konkrete është i mangët duke qenë se: (i) roli i z. Shala në kryerjen e krimeve, si dhe rrethanat e pjesëmarrjes së tij dhe të bashkëkryesve në to, nuk janë të qarta;¹⁸⁴ (ii) të ndaluarit e pretenduar nuk janë identifikuar;¹⁸⁵ (iii) bashkëkryesit e pretenduar të krimeve nuk janë identifikuar por vetëm përmenden si “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së”, ose si “disa anëtarë të UÇK-së”;¹⁸⁶ (iv) përdorimi i frazës “ndër të tjera/ndër të cilët/ku” dhe

¹⁸⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(α)-(δ), që i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, paragrafëve, 14-16, 18-24 (cili ishte roli i z. Shala në këtë krim), 14 (kush saktësisht i mbajti ata në qeli të improvizuara nën roje të armatosur, i prangosi dhe i lidhi, ua mori dokumentet e udhëtimit dhe paratë dhe i bëri objekt të akteve të trajtimit mizor dhe torturës?), 15 (cili ishte roli konkret i secilit prej personave që morën pjesë në transferim?), 16 (çfarë bëri konkretisht z. Shala për të marrë pjesë në “zbatimin dhe vazhdimin e ndalimit arbitrar?”), 18-19, 21, 26 (cili ishte roli konkret i secilit prej personave të përfshirë?), 19 (kush saktësisht i keqtrajtoi të ndaluarit dhe si?), 21 (kush saktësisht urdhëroi rrahjen e [REDAKTUAR]; cili ishte roli i z. Shala në rrahjen dhe keqtrajtimin e të ndaluarve?) 23 (kush [REDAKTUAR] refuzoi [REDAKTUAR]), 26 (cilat vepra u kryen nga z. Shala; kush i mori në pyetje të ndaluarit dhe për çfarë u pyetën ata?), 28 (cili ishte roli i z. Shala në kryerjen e këtij krimi?; a ishte z. Shala i pranishëm gjatë gjithë natës?; cilët anëtarë të UÇK-së këshilluan që [REDAKTUAR]; a ishte z. Shala i pranishëm në atë kohë?; a kishte ai autoritet dhe/ose mjete për [REDAKTUAR] çuar [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR]), dhe 29 (si dhe kur e ka ditur z. Shala se mund të kryhej krimi i vrasjes së paligjshme, që të mund të merrte masa për të parandaluar kryerjen e tij?).

¹⁸⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(α)-(δ) që i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, paragrafëve 14-16, 18-24 (kush ishin të ndaluarit?), paragrafi 14 (kush ishin këta [REDAKTUAR] persona?), 18 (kush u mbajt në kushte çnjerëzore të ndalimit?), 21 (kujt i referohet fraza “një [REDAKTUAR] tjetër [REDAKTUAR] ndaluar?”), dhe 26 (kush janë viktimat?).

¹⁸⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(α)-(δ) që i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, paragrafit 14 (përveç Gecit, Krasniqit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” të cilët u hoqën lirinë së paku [REDAKTUAR] personave?), 15 (përveç [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” që morën pjesë në transferimin e [REDAKTUAR]?), 18 (përveç Gecit, Krasniqit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” që krijuan dhe mbajtën kushte çnjerëzore të ndalimit në fabrikën e metalit në Kukës?), 19 (përveç Gecit, Krasniqit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” të cilët në mënyrë të përsëritur keqtrajtuuan të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës?), 21 (përveç Gecit dhe Krasniqit, kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” që morën në pyetje dhe keqtrajtuuan së paku [REDAKTUAR] të ndaluar?), 23 (përveç Gecit, Krasniqit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” që morën në pyetje dhe rrahën [REDAKTUAR]), dhe 26 (përveç Gecit, Krasniqit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kush janë “disa anëtarë të tjerë të UÇK-së” që u shkaktoan

shprehjes “dhe/ose” në lidhje me faktet materiale të pretenduara,¹⁸⁷ dhe (v) pika e ndalimit arbitrar nuk arrin në nivelin e krimit të luftës.¹⁸⁸

107. ZPS-ja përgjigjet se: (i) Aktakuza e Konfirmuar ofron të dhëna të mjaftueshme për identitetin e personave me të cilët z. Shala ka vepruar në bashkëpunim dhe për rolet e tyre përkatëse;¹⁸⁹ (ii) fraza “ndër të tjera/ndër të cilët/ku”, është përdorur në mënyrë të përshtatshme për të dhënë hollësi të mëtejshme dhe të njohura që mbështesin faktet materiale dhe nuk krijon paqartësi;¹⁹⁰ (iii) nuk është e nevojshme që në aktakuzë të përfshihen të dhënat e sakta në lidhje me viktimat;¹⁹¹ dhe (iv) kundërshtimi i cilësimit ligjor të ndalimit arbitrar nuk është kundërshtim ndaj formës së aktakuzës.¹⁹²

108. Për sa i përket rolit konkret që pretendohet se ka luajtur z. Shala ose bashkëkryesit në lidhje me krimet e parashtruara në aktakuzë të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme (“katër krimet e pretenduara”), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, në varësi të konstatimeve të bëra më sipër në lidhje me incidentet e përshkruara në paragrafët 22, 23 dhe 28 të Aktakuzës së Konfirmuar,¹⁹³ në Aktakuzën e Konfirmuar argumentohet me konkretësi të mjaftueshme lidhja ndërmjet z. Shala dhe krimeve të përfshira në Aktakuzë, si dhe rolet që pretendohet se ka luajtur ai dhe bashkëkryesit e tij të pretenduar. Pasi ka shqyrtuar me kujdes elementet e parashtruara nga Mbrojtja,¹⁹⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk është nevoja që ato të paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar pasi më tepër janë çështje provash për të cilat do të vendoset në gjykim.

viktimave dhimbje ose vuajtje të rënda?); *shih gjithashtu* para. 56-57, me referenca konkrete në paragrafët 8, 11, 14, 15, 18, 19, 21, 22, 24, 26, 28 të Aktakuzës së Konfirmuar.

¹⁸⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para

¹⁸⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(α), që u referohet paragrafëve 14-17 të Aktakuzës së Konfirmuar.

¹⁸⁹ Përgjigjja, para, 39.

¹⁹⁰ Përgjigjja, para. 40.

¹⁹¹ Përgjigjja, para. 42.

¹⁹² Përgjigjja, para. 43.

¹⁹³ *Shih* para. 69-73 më lart.

¹⁹⁴ *Shih* poshtëshënimin 184 më lart.

109. Sa i përket identitetit ose numrit të saktë të viktimave të veprës penale të ndalimit të paligjshëm/arbitrar ose arrestimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij se Aktakuza e Konfirmuar jep informacion të mjaftueshëm për identitetin e viktimave dhe konstaton se informacioni i mëtejshëm në lidhje me përbërjen ose prejardhjen e këtij grupi ose kategorie,¹⁹⁵ ose mbi statusin e viktimave në momentin e arrestimit të tyre ka të bëjë me provat dhe do të shtjellohen në gjykim.¹⁹⁶

110. Lidhur me identitetin e kryesve fizikë të katër krimeve të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimet e tij të bëra më lart në paragrafët 55-57, 86 dhe 94, dhe konstaton se nuk është nevoja që në Aktakuzën e Konfirmuar të paraqiten hollësi të tjera në lidhje me identitetin e kryesve/bashkëkryesve fizikë të katër krimeve¹⁹⁷. Këto më tepër janë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

111. Për sa i përket përdorimit të frazës “ndër të tjera/ndër të cilat” gjatë gjithë Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton në fillim konstatimet e bëra prej tij më lart në lidhje me përdorimin e saj në paragrafët 11 dhe 16 të Aktakuzës së Konfirmuar.¹⁹⁸ Sa i takon përdorimit të fjalës “ku” në fjalinë e tretë të paragrafit 23 dhe në paragrafin 28 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ai ka urdhëruar ZPS-në të sqarojë nëse po argumenton se z. Shala ka marrë pjesë personalisht në këtë incident të pretenduar apo jo,¹⁹⁹ dhe konstaton se ndryshime të tilla do të trajtojnë çdo paqartësi që rrjedh nga përdorimi i frazës “ku disa” në raste të tilla.

112. Për sa i përket përdorimit të frazës “ndër të cilët/ndër të tjera” në paragrafët 14, 18, 19, 21, 23 (fjalë e parë), dhe 26 (fjalë e parë, herë e parë dhe fjalë e dytë) të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në secilin rast, formulimi i përdorur pas frazës “ndër të cilët/ ndër të tjera” ka për qëllim të ofrojë

¹⁹⁵ *Shih* poshtëshënimin 185 më lart.

¹⁹⁶ *Shih* para. 103 më lart.

¹⁹⁷ *Shih* poshtëshënimin 186 më lart.

¹⁹⁸ *Shih* para. 75 më lart.

¹⁹⁹ *Shih* para. 73 më lart.

më shumë konkretësi sa u takon incidenteve të trajtuara, si identiteti i kryesve fizikë,²⁰⁰ hollësi të tjera lidhur me disa prej viktimave,²⁰¹ armët e përdorura në incidentet faktike,²⁰² mënyra në të cilën pretendohet se u krye keqtrajtimi ndaj të ndaluarve.²⁰³ Përcaktime të tilla nuk i japin mundësi ZPS-së t'i zgjerojë në mënyrë të palejueshme pretendimet faktike të çështjes së saj dhe fushëveprimin e akuzave në gjykim. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i frazës “ndër të cilët/ndër të tjera” në rastet e lartpërmendura nuk e bën me mangësi paraqitjen e katër krimeve.

113. Për sa i përket përdorimit të frazës “ndër të tjera” në paragrafin 26 të Aktakuzës së Konfirmuar (fjalja e parë, hera e dytë), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se formulimi i përdorur pas kësaj fraze ka për qëllim të ofrojë më shumë konkretësi për një kategori të caktuar, pra arsyet për të cilat pretendohet se janë diskriminuar viktimat dhe, për rrjedhojë, kjo nuk i jep mundësi ZPS-së t'i zgjerojë në mënyrë të palejueshme pretendimet faktike të çështjes së saj dhe fushëveprimin e akuzave në gjykim.²⁰⁴

114. Në lidhje me detajet e tjera të përmendura nga Mbrojtja,²⁰⁵ pas një shqyrtimi të hollësishëm Gjykatësi i Procedurës Paraprake , konstaton se ato nuk përbëjnë fakte

²⁰⁰ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 14, 18, 19 (fjalja e parë, hera e parë), 21 (fjalja e parë, hera e parë), 26 (fjalja e parë, rasti i parë, hera e parë dhe fjalja e dytë).

²⁰¹ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 21 (fjalja e parë, hera e dytë).

²⁰² Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 21 (fjalja e tretë), 23.

²⁰³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 19 (fjalja e parë, hera e dytë dhe i tretë).

²⁰⁴ Për ngjashmëri, Vendimi në lidhje me Aktakuzën *Thaçi dhe të tjerët*, para. 166.

²⁰⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 64(α), (β), (δ), që i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, paragrafit 14 (a iu nënshtruan masave dhe/ose trajtimit të tillë që të [REDAKTUAR] personat? kush i arrestoi ata dhe ku? për sa kohë u mbajt i ndaluar secili prej tyre?, 15 (kush i bëri roje [REDAKTUAR] dhe kush e kërcënoi me vdekje?), 18 (a u zbatuan kushte të tilla në lidhje me të gjithë në fabrikën e metalit në Kukës? në çfarë mënyre konkretisht heqja e lirisë pa proces ligjor të rregullt përbënte kushte çnjerëzore të ndalimit?), 19 (a u keqtrajtuat të gjithë të ndaluarit? kush ishin ata që u detyruan të bënin punë krahu gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar? kush i detyroi të bënin punë krahu?), 20 (a rriheshin thuajse çdo ditë të gjithë të ndaluarit? çfarë masash duhej të kishte marrë z. Shala “për parandalimin ose kufizimin e dhunës”? a kishte ai autoritet për të marrë masa të tilla dhe mbi çfarë baze?), 21 (a u kërcënuan të gjithë të ndaluarit dhe akuzuan si bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe/ose si mospërkrahës të UÇK-së? kush ishte anëtar i UÇK-së që e informoi [REDAKTUAR] se ishte dënuar me burgim dhe

mbi të cilat mbështeten akuzat dhe, për rrjedhojë, nuk është nevoja të paraqiten veças në Aktakuzën e Konfirmuar. Këto janë aspekte provash që mund të diskutohen në gjykim.

115. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se parashtrimi i z. Shala se ndalimi arbitrar nuk mund të cilësohet si krim lufte nuk është kundërshtim ndaj formës së aktakuzës, por një çështje juridike dhe, rrjedhimisht, rrëzohet pa u shqyrtuar.²⁰⁶

116. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se katër krimet janë paraqitur me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar dhe rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt.

PËRFUNDIM

117. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, për të siguruar nivelin e kërkuar të konkretësisë dhe të qartësisë dhe për të siguruar që ZPS-ja të mos mund ta zgjerojë më tej çështjen e saj në gjykim, në Aktakuzën e Konfirmuar duhen bërë ndryshimet e përcaktuara në paragrafët 69, 73, 75 më lart. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Aktakuza e Konfirmuar paraqet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat mbështeten akuzat dhe krimet, përfshirë format e përgjegjësisë për të cilat ngrihen akuzat. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon pjesën e mbetur të kundërshtimeve të Mbrojtjes ndaj formës së Aktakuzës së Konfirmuar.

ekzekutim?), dhe 24 (kush pësoi lëndime dhe çfarë lëndimesh pësoi si pasojë e trajtimit të tyre në fabrikën e metalit në Kukës?).

²⁰⁶ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka trajtuar në një vendim tjetër argumentet e Mbrojtjes se DHS-ja nuk ka juridiksion mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar. *Shih* Vendimi në lidhje me Juridiksionin, para. 98-103.

V. VENDIM

118. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON PJESËRISHT**, Mocionin e Mbrojtjes në masën e përcaktuar në këtë vendim;
- (b) **URDHËRON ZPS-në** të parashtrojë brenda **të hënës, datë 1 nëntor 2021**, një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar, sipas udhëzimeve që jepen në paragrafët 69, 73, 75.;
- (c) **RRËZON** pjesën e mbetur të Mocionit të Mbrojtjes;
- (d) **URDHËRON ZPS-në** të parashtrojë brenda **të hënës, datë 1 nëntor 2021**, një version të redaktuar publik të Përgjigjes; dhe
- (e) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë si publike Kundërpërgjigjen.

nënshkrimi

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 18 tetor 2021

Në Hagë, Holandë.